REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PRISHTINËS OPŠTINA PRIŠTINA
20 -11- 2026
14-016/ BR. 01 - 173041/26

KOMUNA E PRISHTINËS
ZYRA E NËNKRYETARES SË KRYEQYTETIT

Lënda: Kërkesë për angazhim parlamentar lidhur me mos-nënshkrimin e marrëveshjes për projektin me KfW-në për menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Prishtinës nga Ministri i Financave

Po ju shkruaj lidhur me një çështje që prek drejtpërdrejt jetën e përditshme të rreth **450 mijë qytetarëve** të rajonit të Prishtinës: mungesën e kapaciteteve të nevojshme për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave.

Që nga viti 2023, Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi", Ministria e Financave, Komuna e Prishtinës dhe banka gjermane për zhvillim KfW kanë zhvilluar një proces të gjatë për përgatitjen e projektit të modernizimit të menaxhimit të mbeturinave në rajonin e Prishtinës. Projekti i dakorduar mes të gjitha palëve parasheh investime në vlerë të përgjithshme prej **74.1 milionë eurosh**, të ndara në dy faza (shih dokumentin 1 të bashkangjitur).

Faza e parë, prej **24.1 milionë eurosh (4.1 milionë euro grant** dhe **20 milionë euro kredi të butë)**, përfshin blerjen e rreth **100 kamionëve të rinj, 10 mijë kontejnerëve** si dhe modernizimin e shërbimit të pastrimit. Faza e dytë parasheh edhe rreth **50 milionë euro** investime të planifikuara për ndërtimin e qendrës për riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave dhe zgjerimin e mëtejëm të kapaciteteve.

Ky projekt është trajtuar në negociatat ndërqeveritare Kosovë-Gjermani të mbajtura në Prill të vitit 2024, ndërsa më 18 dhjetor 2024, Qeveria e Kosovës ka miratuar në parim nismën për lidhjen e marrëveshjes së kredisë, duke obliguar Ministrinë e Financave të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë (shih dokumentin 2 të bashkangjitur).

Megjithatë, marrëveshja e grantit dhe e kredisë ende **nuk është nënshkruar** nga **Ministri i Financave, Hekuran Murati.** Pas takimeve me KfW-në, jemi njoftuar që Ministri Murati po refuzon ta fillojë projektin që e zgjidhë çështjen e menaxhimit të mbeturinave në Prishtinë.

Më **15 maj 2026,** Komuna e Prishtinës, KRM "Pastrimi" dhe KfW i janë drejtuar bashkërisht ministrit të Financave, Hekuran Murati, me kërkesë për përshpejtimin e procedurave dhe finalizimin e marrëveshjes (shih dokumentin 3 të bashkangjitur). Fatkeqësisht, **Ministri Murati ende po refuzon të fillojë projektin.**

Për këtë arsye, **kërkoj nga ju** që, përmes mekanizmave parlamentarë, **të kërkoni sqarime zyrtare** nga Ministria e Financave për statusin e marrëveshjes dhe arsyet e mungesës të nënshkrimit të këtij projekti kaq të rëndësishëm për rajonin e Prishtinës.

Kjo çështje nuk duhet të trajtohet si përplasje ndërmjet institucioneve apo partive politike. Është çështje e shërbimeve publike, e mjedisit dhe e cilësisë së jetës së qytetarëve. Kërkoj angazhimin tuaj si deputetë të Prishtinës që të ngrisni zërin tuaj që të mbrohet interesi i qytetarëve të Prishtinës e të tejkalohen inatet politike.

Prishtina ka nevojë për zgjidhje konkrete, ndërsa qytetarët kanë të drejtë të dinë pse një projekt kaq i rëndësishëm vazhdon të mbetet pa marrëveshje përfundimtare të financimit. Pres angazhimin tuaj institucional lidhur me hapat që mund të ndërmerrni në kuadër të kompetencave tuaja parlamentare.

Nëse ju duhen informata shtesë rreth projektit, ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni.

Me respekt,

Besianë Musmurati
Nënkryetare e Kryeqytetit
Komuna e Prishtinës

